



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1524/1 prot.

Tiranë, më 10. 12. 2025

V E N D I M

Nr. 293, datë 10. 12. 2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, është paraqitur ankesa nr. 299 Regj., datë 27.11.2025, e shtetases S. B kundër Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) dhe Zyrës së Shërbimit Postar Bajram Curri, me pretendim diskriminimin për shkak të “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, ka parashtruar, ndër të tjera, si vijon:

“Unë jam S. B, viktimë e veprës penale dhe kallëzuese e veprës penale. Kërkesa ime ka të bëjë me shkeljen e neneve 6, 13,14,17,18, 34, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Ka të bëjë me konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë hetimit dhe gjyqimit në të gjitha shkallët e sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë.

¹ Në vijim referuar me akronimin KMD ose si Komisioneri.

- Cenim të së drejtës për respektimin e dispozitave procedurale si në hetim dhe në gjykim;
- Cenim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme e të drejtës për t'u dëgjuar;
- Cenim i të drejtës të cilësive juridike të viktimës dhe të kallëzueses së veprës penale;
- Cenim i aksesit në gjykatë;
- Cenim i së drejtës së mbrojtjes;
- Cenim i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit;
- Cenim i standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor;
- Cenim i së drejtës së kompetencës ligjore pas transferimit të prokurorit;
- Cenim i parimit të barazisë para ligjit;
- Cenim i parimit të mosdiskriminimit;
- Cenim i pozitës dhe figurës me vendime dhe akte e sjellje që diskretitojnë figurën e gjyqtarit dhe prokurorit.

Kërkuesja S. B ka ushtruar detyrën e inspektore pranë Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, (DRAKU) Kukës. Punëdhënësi më ka përjashtuar nga Shërbimi Civil, në vitin 2014, në mënyrë të padrejtë dhe për më tepër nëpërmjet një akti kriminal, duke fallsifikuar dokumente zyrtare dhe duke i konsideruar si të vërteta, mbi bazën e të cilave më ka penalizuar duke më larguar nga Shërbimi Civil. Për këto fakte jam ankuar konform ligjit në rrugë administrative dhe gjyqësore, duke ngritur padi në Gjykatën Administrative Tiranë.

Ndërsa për faktin e fallsifikimit të dokumentave zyrtare nga ana e instancave përkatëse të punëdhënësit (mbi bazën e të cilave u bë dhe largimi im nga Shërbimi Civil) kam bërë kallëzim penal në Prokurorinë e Kukësit, bazuar në juridiksionin e kompetencën e kësaj të fundit.

Faktet që flasin për korrupsion nga ana e administratës, gjyqtarëve dhe prokurorëve i kemi bërë të njohura publikisht dhe në emisione të ndryshme investigative televizive.

Sulmi është agravuar duke u bërë më agresiv ndaj meje pas këtyre publikimeve e denoncimeve, i nxitur dhe nga politika dhe fakti që i kam denoncuar publikisht këto vepra penale (përfshirë edhe Kancelarin e Gjykatës së Tropojës, z. Sh. M, punonjësit e Policisë Gjyqësore dhe Prokurorinë e Kukësit të cilët kanë mbështetur veprimet e tij).

...ankuesja S. B është larguar nga Shërbimi Civil mbi bazën e dokumenteve të fallsifikuara dhe të provuara me akt ekspertizat e Policisë Shkencore, por nga gjithë shkallët e gjykimit, duke përfshirë edhe Gjykatën Kushtetuese, provat e Policisë Shkencore nuk i njohin dhe nuk i pranojnë në çështjen administrative nr. 648/2024, e cila është për gjykim për herë të dytë në Gjykatën Kushtetuese. Si tek çështja administrative, ashtu dhe tek ajo penale, janë zhdukur e fallsifikuar aktet nga gjyqtarët e prokurorët që hetojnë e gjykojnë të gjitha çështjet e ankueses S. B.

Me zhdukjen e këtyre akteve më janë zhdukur dhe të drejtat ligjore kushtetuese dhe të KEDNJ, siç ndodhi dhe me zhdukjen e ankimeve të datës 23.07.2024 dhe 18.06.2025, të çështjeve penale të viteve 2016 e 2018, që i ishin drejtuar GJEDNJ me anë të Shërbimit Postar.

Ky është një krim shtetëror ndaj meje, si ish punonjëse me status të Nëpunësit Civil, vetëm për faktin se unë kam zbatuar ligjin dhe vetëm ligjin.

Ndërsa inspektorët që fallsifikojnë aktet zyrtare dhe prokurorët e gjyqtarët që kryejnë vepra penale të zhdukjes e fallsifikimit, shpërdorimit të detyrës, qëndrojnë në detyrë, pasi kanë mbrojtje politike dhe qëndrojnë mbi ligjin. Çfarë drejtësie kërkojmë ne nga padrejtësia?

Kërkoj që kjo taktikë antiligjore të ndërpritet menjëherë, pasi sa herë unë ankuesja S. B do të dërgoj ankime të tjera pranë GJEDNJ, do të përdoren veprimet e kundërligjshme siç u veprua me ankimet e datave 23.07.2024 dhe 18.06.2025, që nuk u regjistruan në faqen zyrtare dhe u zhdukën nga GJEDNJ dhe Shërbimi Postar.

Momentalisht në Gjykatën Kushtetuese ndodhen për gjykim dy çështje të cilat janë në pritje për gjykim nga kjo gjykatë, më pas do t'i drejtohem GJEDNJ-së.

Përfundimisht kërkoj që këtë ankesë ta trajtoni në bazë të KEDNJ-së, duke nxjerrë përgjegjësin e këtyre veprimeve antiligjore dhe kriminale, deri në kryerjen e veprave penale të mashtrimit, fallsifikimit dhe shpërdorimit të detyrës me anë të korrupsionit nga personat/punonjësit e Shërbimit Postar në bashkëpunim e bashkërendim me personat në emër të GJEDNJ, duke cenuar parimin e aksesit në GJEDNJ, duke më cenuar njëherësh dhe parimin e mosdiskriminimit nga ana e GJEDNJ në bashkëpunim me Shërbimin Postar.

Ankimet e mija u zhdukën nga faqja zyrtare e GJEDNJ-së dhe nuk u regjistruan për t'u gjykuar. Ato u zhdukën njësoj siç kanë vepruar dhe gjykatat e sistemit shqiptar."

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar, ndër të tjera, nga Komisioneri: "Kërkoj që ankimimi i datës 18.06.2025, i znj. S. B të regjistrohet në faqen zyrtare të GJEDNJ-së, për t'u gjykuar në bazë të nenit 34, të KEDNJ-së".

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, përcaktohet se: "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore,

përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga subjekti ankues pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:

Lidhur me kërkimin e subjektit ankues për:

- Pretendimet për shkeljet ligjore të konsumuara nga instancat shtetërore si: kryerjen e veprave penale të mashtrimit, fallsifikimit dhe shpërdorimit të detyrës me anë të korrupsionit, nga ana e punonjësve të Shërbimi Postar dhe gjyqtarëve e prokurorëve;
- Për shkelje nga ana e Gjykatave shqiptare dhe të GJEDNJ-së, së të drejtave të saj themelore, të standardeve ndërkombëtare dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, lidhur me pretendimet për mosregjistrim të çështjeve/ankimeve të saj në faqen zyrtare të GJEDNJ-së, Komisioneri vëren se, hetimi i tyre nuk bën pjesë në kompetencën e KMD-së.

Komisioneri evidenton se, ankimimi i vendimeve të organeve gjyqësore të sistemit shqiptar,

bëhet sipas hierarkisë, në shkallët më të larta të gjykatave respektive dhe se shqyrtimi i tyre është jashtë kompetencave të KMD-së.

Kodi i Procedurës Civile, i ndryshuar, në nenin 452², të tij, lidhur me të drejtën e ankimit kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë, ka përcaktuar se:

“1. Mund të ankimohen në gjykatën e apelit të gjitha vendimet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë, me përjashtim të rasteve kur ankimi përjashtohet me ligj”.

Për rrjedhojë, bazuar në sa më sipër, nëse subjekti ankues nuk është dakord me vendimarrjen e Gjykatës së Shkallës së Parë, lidhur me pretendimet e tij, atij i lind e drejta e ankimit të vendimit në Gjykatën e Apelit, bazuar në dispozitat ligjore specifike.

Neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikon se: *“Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës”.*

Në vendimin nr. 11, datë 27.05.2004, të Gjykatës Kushtetuese³, ndër të tjera, thuhet se: *“Në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, është përcaktuar se: “...vendimet gjyqësore mund të jenë objekt shqyrtimi vetëm mbi bazën e ankimeve ose rekurseve në rrugë gjyqësore, sipas përcaktimeve në kodet e procedurave ose në ligje të veçanta”. Pra, meqenëse ky pushtet ushtrohet në mënyrë të shkallëzuar sipas parimit të kontrollit të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta, asnjë organ tjetër, nuk ka të drejtë të kontrollojë e vlerësojë bazueshmërinë në ligj të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të mospërfillin përmbajtjen e tyre e të ngarkojnë me përgjegjësi gjyqtarin e çështjes. Duke iu referuar praktikës së saj, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme për të rikonfirmuar qëndrimin se, vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë, e se, asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore, për sa kohë, ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë”.*

Pretendimet e ankueses mund të zgjidhen vetëm nëpërmjet kontrollit gjyqësor, ankimit përpara gjykatave të shkallëve më të larta.

Në nenin 194/1 të ligjit nr. 115, datë 03.11.2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë është autoriteti*

² Neni 452 - “Vendimet që mund të ankimohen”.

³ “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, në nenin 132, të saj, ka përcaktuar se: *“Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim”.*

shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë”.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim apo kontrolli i vendimmarrjeve të gjykatave, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj⁴.

Lidhur me pretendimin tjetër për shkelje të të drejtave të saj nga ana e GJEDNJ-së, Komisioneri, vëren se:

Gjykata e Strasburgut/GJEDNJ, është një gjykatë ndërkombëtare me seli në Strasburg të Francës.. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka juridiksion në rast se kërkuar ka qenë personalisht dhe drejtpërdrejtë viktimë e shkeljes së të drejtave dhe garancive të përcaktuara në Konventë apo Protokollet e saj. Shkelja duhet të jetë kryer nga një nga shtetet që kanë nënshkruar Konventën dhe kërkuar duhet të ketë ezauruar shkallët e gjykimit në vendin ku kanë ndodhur shkeljet , përpara së të paraqesë kërkesë pranë Saj.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) interpreton dhe zbaton të drejtat e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe protokollet e saj. Vendimet e Gjykatës janë të detyrueshme dhe u kërkojnë Shteteve të korrigjojnë shkeljet dhe të zbatojnë masa për të parandaluar çështjet e ardhshme.

Për sa më lart, regjistrimi dhe shqyrtimi i çështjeve gjyqësore që i daresohen GJEDNJ-së, është atribut dhe kompetencë vetëm e kësaj Gjykate, dhe jashtë kompetencave të çdo organi tjetër (gjyqësor) që vepron në Republikën e Shqipërisë.

Pretendimi i tjetër i ankueses lidhur me veprimet e punonjësve të Shërbimit Postar, Prokurorisë, Gjyqësorit dhe Policisë Gjyqësore, qartazi i lidh veprimet e këtyre të fundit,, me akuzën për konsumim të elementëve të veprës penale të shpërdorimit të detyrës.

Neni 1, dhe 1/b, i Kodit Penal, përcakton se: *“Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre. Veprat penale ndahen në krime dhe në kundravajtje penale. Legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë ka për detyrë të mbrojë pavarësinë e shtetit*

⁴ Për analogji citojmë Vendimin nr. 02, datë 11.01.2021 dhe Vendimin nr. 112, datë 22.06.2023, të KMD-së.

dhe tërësinë e territorit të tij, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën, mjedisin, bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shqiptarëve me pakicat kombëtare, si dhe bashkëjetesën fetare nga veprat penale, si dhe parandalimin e tyre”.

Kodi i Procedurës Penale, në nenet 277 e 278 të tij, ka parashikuar organet kompetente që ushtrojnë ndjekjen penale dhe që shprehen e disponojnë lidhur me të, shprehimisht: *“Prokurori dhe policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale. Prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore. Gjatë hetimeve paraprahe, për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, viktimës dhe palëve private, vendos gjykata.”*

Nisur nga sa më sipër, lidhur me ngjarjen në fjalë, është organi i Prokurorisë, organi kompetent që ushtron ndjekjen penale.⁵

Për rrjedhojë, nisur nga sa më sipër, Komisioneri vëren se, hetimi i veprimeve, për të cilat ka dyshime të arsyeshme se mund të përbëjnë elementë të veprës penale, siç ankuesja pretendon për shpërdorim detyre, korrupsion, fallsifikim të akteve zyrtare e mashtrim, *(që hetohen e shqyrtohen nga organet përkatëse kompetente, si Prokurori e Gjykatë)*, nuk bën pjesë në kompetencën e KMD-së⁶.

Përfundimisht, Komisioneri vlerëson se,

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 12/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues S. B, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.

⁵ Neni 148, i Kushtetutës së Shqipërisë shpreh se: *“Prokuroria ushtron ndjekjen penale...”*

⁶ Për analogji citojmë vendimet: nr. 22, datë 19.01.2024, nr. 218, datë 05.08.2024, nr. 85, datë 14.04.2025, etj, të KMD-së.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA